



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE

RAPORTI VJETOR 2021

Tiranë, 2022

Hyrje

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë prej vitesh u ka dhënë prioritet publikimeve të ndryshme për veprimtarinë e saj, atyre të përvitshme të vendimeve, por edhe të posaçme, siç është raporti i veprimtarisë së saj vjetore. Në një shoqëri demokratike transparenca është një element i rëndësishëm i konsolidimit të shtetit të së drejtës. Si një prej objektivave strategjikë prioritar të Gjykatës, ajo përfaqëson një vlerë që manifestohet si standard i rëndësishëm dhe thelbësor si në administrimin e drejtësisë edhe në drejtim të pasqyrimin të organizimit dhe funksionimit të Gjykatës Kushtetuese. Ky buletin synon që të garantojë transparençën dhe të rrisë aksesin e publikut në Gjykatën Kushtetuese.

Është kënaqësi e veçantë t'iu prezantoj veprimtarinë e institucionit tonë për vitin 2021 nëpërmjet këtij raporti, i cili përfshin informacion si për veprimtarinë gjyqësore, ashtu edhe për atë administrative, sipas kompetencave të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji, si dhe reflekton përpjekjet e punën që institucioni ynë ka realizuar në përmbushje të misionit të tij. Gjykata Kushtetuese, përmes veprimtarisë së saj, ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në drejtim të mbrojtjes së parimeve kushtetuese, në ndarjen dhe balancimin e pushteteve, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve.

Gjatë veprimtarisë së saj që nga krijimi e gjer më sot Gjykata Kushtetuese ka pasur rastin të shqyrtojë çështje të natyrave dhe përmasave të ndryshme, duke krijuar hap pas hapi një praktikë të pasur, ku të bie në sy përpjekja e vazhdueshme për t'i dhënë mbrojtjen e duhur parimeve kushtetuese.

Edhe gjatë vitit 2021 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në përmbushje të funksionit të saj si autoriteti më i lartë në mbrojtjen e vlerave kushtetuese dhe garante e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, është përpjekur që me gjithë dinamikën e vazhdueshme dhe llojshmërinë e problematikave që janë shtruar para saj për zgjidhje, të gëzojë nivel të lartë besimi si te qytetarët ashtu dhe institucionet shtetërore, i cili është rritur falë punës së përkushtuar të gjyqtarëve dhe stafit tonë. Për të përballuar sfidat e jashtëzakonshme që lindën nga pandemia, Gjykatës iu desh të përshtaste proceset e saj të punës me kufizimet e pandemisë për të ruajtur funksionimin e duhur. Pavarësisht rrethanave sfiduese, Gjykata arriti të mirëadministrojë ngarkesën e saj të lartë të punës, të krijuar veçanërisht si pasojë mosfunksionimit të saj prej 3 vitesh si rezultat i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve. Jo vetëm kaq, por në fakt, ajo arriti të zvogëlojë numrin e përgjithshëm të proceseve në pritje. E gjithë puna voluminoze u përballua nga një trupë gjyqësore prej 7 gjyqtarësh nga 9 gjyqtarë që duhet të ketë në përbërjen e saj kjo gjykatë. Masat e ndërmarra nga organet drejtuese të Gjykatës rezultuan efikase në kohë edhe në cilësi, pasi jo vetëm që gjykimi i çështjeve të prapambetura përfundoi në një kohë të shkurtër por u arrit të ruhej dhe të zhvillohej cilësia e vendimeve dhe shërbimeve që i ofrohen publikut.

Gjatë vitit 2021 në Gjykatë janë paraqitur 160 kërkesa, numri i vendimeve është më i lartë për shkak të kërkesave të paraqitura prej vitit 2017 dhe të pashqyrtuara për shkak të mungesës së kuorumit të gjyqtarëve. Në rritje ka qenë edhe numri i vendimeve të moskalimit, në të cilat Gjykata nuk shqyrton themelin e pretendimeve por kriteret e pranueshmërisë së kërkesave të paraqitura para saj. Gjatë këtij viti janë dhënë në total 201 vendime, prej të cilave 159 janë vendimet të marra nga kolegjet dhe Mbledhja e Gjyqtarëve gjatë shqyrtimit paraprak të çështjeve, të cilat përbëjnë gjithashtu një kontribut të vyer në pasurimin e jurisprudencës kushtetuese shqiptare, ndërsa 42 janë vendime përfundimtare të seancave plenare publike dhe mbi bazë dokumentesh.

Disa nga vendimet kryesore që mori Gjykata dhe që patën impakt dhe ndjeshmëri në publikun e gjerë janë: ai për kontrollin e kushtetutshmërisë së urdhrin të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në lidhje me kufizimet për shkak të pandemisë; vendimi për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së

Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme; interpretimi i nenit 98, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës midis Presidentit të Shqipërisë dhe Kryeministrit; shfuqizimi i pikës 1 të nenit 162 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” për pragun kombëtar elektoral; etj. Këto dhe vendime të tjera janë paraqitur në raportin vjetor së bashku me informacionin bazë, statistika, si dhe shifra interesante për Gjykatën dhe historinë e saj. Gjithashtu, në vijim të traditës së kësaj Gjykate, vendimet botohen duke synuar praktikitetin në shfrytëzimin e tyre nga rrethi i juristëve e më gjerë. Këto vendime paraqesin rëndësi të madhe dhe përbëjnë një kontribut me vlerë në pasurimin e përvojës së Gjykatës Kushtetuese dhe i shtohen fondit të burimeve të brendshme të së drejtës kushtetuese shqiptare dhe së drejtës në përgjithësi.

Ky raport vjetor ofron edhe një pasqyrë të veprimtarisë administrative të Gjykatës, si dhe një përmbledhje të shkurtër të aktiviteteve dhe marrëdhënieve me jashtë për vitin 2021. Në këto afro tri dekada të krijimit të saj, Gjykata Kushtetuese është konfiguruar si institucion kushtetues duke u rreshtuar krahas simotrave të saj evropiane. Gjykata Kushtetuese është në vazhdimësi e angazhuar për rritjen dhe zgjerimin e bashkëpunimit të saj me institucionet vendase dhe ato në nivel ndërkombëtar. Në funksion të përmbushjes së këtij qëllimi, Gjykata merr pjesë në konferencat e organizatave më të rëndësishme të drejtësisë kushtetuese, ku ajo aderon prej vitesh, në vizitat studimore në gjykata kushtetuese/institucione me juridiksion ekuivalent të vendeve të tjera, në gjykatat ndërkombëtare, në programe të ndryshme trajnimit të GJEDNJ-së etj.

Gjatë vitit të kaluar, gjyqtarët morën pjesë në aktivitete ndërkombëtare, disa prej të cilave u realizuan në mënyrë virtuale, për shkak të kufizimeve të diktuar nga pandemia. Ashtu sikurse edhe gjykatat e vendeve të tjera, Gjykata u mbështetëm në formatet digjitale për t’u angazhuar në këto aktivitete që lejuan gjyqtarët të diskutojnë dhe trajtojnë tema të ndryshme kushtetuese me homologët e tyre.

Në përmbyllje, vlen të theksojmë se vend për kritika, përmirësime dhe zhvillime të mëtejshme mund të ketë dhe në çdo rast ato do të adresohen me përkushtim maksimal, por nisur nga fakti që në një kohë të shkurtër, në kushte të kufizuara dhe aspak normale duhej të merreshin vendime për çështje të rëndësishme dhe sensitive, ky organ me vendimmarrjen e tij ka arritur të demonstrojë integritet, përgjegjshmëri, profesionalizëm të lartë dhe paanshmëri objektive, si dhe njëkohësisht të bëhet model suksesi dhe referimi për institucionet e tjera që japin drejtësi në këtë vend.

Në përfundim shprehim bindjen se ky buletin do të përbëjë një instrument të rëndësishëm në forcimin e transparencës dhe aksesit të publikut dhe aktorëve të interesuar për veprimtarinë e Gjykatës si një nga institucionet kryesore të shtetit të së drejtës.

Raporti vjetor për vitin 2021

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë nuk bën pjesë në sistemin gjyqësor të zakonshëm. Ajo ka një juridiksion të veçantë për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjerë normativë. Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj (neni 124/1 i Kushtetutës). Gjatë ushtrimit të funksionit të saj ajo i nënshtrohet vetëm Kushtetutës (neni 124/2 i Kushtetutës).

MBLEDHJA E GJYQTARËVE

Mbështetur në nenin 13 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” nr. 8577, datë 10.02.2000 dhe Rregullores së brendshme, Mbledhja e gjyqtarëve *Mbledhja e Gjyqtarëve*:

- Ka përcaktuar drejtimit kryesore të shpenzimeve të mjeteve buxhetore me vendimin nr. 2, sipas buxhetit të miratuar me ligjin nr. 115/2024 datë 15.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”.
- Është informuar çdo 6-muaj me raporte mbi shpenzimet buxhetore;
- Ka miratuar Planin Strategjik për vitin 2021-2023

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Sipas nenit 14 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” nr. 8577, datë 10.02.2000, Sekretari i Përgjithshëm është Nëpunësi më i lartë civil në Gjykatën Kushtetuese. Shërbimet e tjera të nevojshme për funksionimin e Gjykatës Kushtetuese kryhen nga nëpunës dhe punonjës të tjerë.

Sekretari i Përgjithshëm drejton veprimtarinë administrative të Gjykatës Kushtetuese, nën autoritetin e Kryetarit të saj.

Gjatë vitit 2021 janë realizuar:

- Ka realizuar analizën vjetore “Mbi veprimtarinë e Administratës së Gjykatës Kushtetuese”
- Raportet të veprimtarisë së realizuar nga drejtoritë përkatëse


ADMINISTRATA E GJYKATËS KUSHTETUESE

Bazuar në nenin 13, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, struktura e administratës së Gjykatës Kushtetuese miratohet nga mbledhja e gjyqtarëve e cila vendos numrin e punonjësve, organizimin, pagat dhe detyrat, që duhet të plotësojë ajo. Struktura e administratës së Gjykatës Kushtetuese përbëhet:

- Kabineti i Kryetarit
- Sekretari i Përgjithshëm
- Këshilltarët e gjyqtarëve
- Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit
- Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe me Jashtë
- Drejtoria Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore
- Drejtoria e Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes

ORGANIGRAMA DHE STRUKTURA ORGANIZATIVE E GJYKATES KUSHTETUESE TE R.SH.

ORGANIGRAMA DHE STRUKTURA ORGANIZATIVE E GJYKATES KUSHTETUESE TE R.SH.



Me vendimin nr. 5, datë 29.03.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve u miratua Strategjia për Gjykatën Kushtetuese e cila mbulon periudhën kohore 2021-2023. Ajo përfshin objektiva strategjike dhe objektiva specifike në funksion të përmbushjes së vizionit të Gjykatës. Nga ana metodologjike, progresi i arritjes së objektivave do të matet përmes treguesve të suksesit (indicators), të përcaktuar në nivel objektivash specifike dhe përmbushjes së aktiviteteve që janë të përfshira në planin trevjeçar të veprimit, i cili paraqitet si pjesë integrale e Strategjisë.

Konkretisht gjatë këtij viti në këtë drejtim u ndërmorën disa masa:

- Për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në regjistrimin, menaxhimin dhe monitorimin e shqyrtimit të çështjeve;
- Për rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor, studimeve, si dhe ruajtja dhe zhvillimi i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese;
- Për rritjen e transparencës së veprimtarisë së Gjykatës, përmirësimi i komunikimit dhe informimit të vazhdueshëm të publikut;
- Për zgjerimi i bashkëpunimit të Gjykatës me institucionet vendase dhe ato në nivel ndërkombëtar

Të gjitha këto masa janë reflektuar pozitivisht në veprimtarinë e Gjykatës duke ndikuar në efektivitetin e punës së çdo drejtorie.

Në vijim disa nga drejtimet kryesore të veprimtarisë së Gjykatës për vitin 2021:

KËRKESAT DREJTUAR GJYKATËS KUSHTETUESE GJATË VITIT 2021

(sipas nenit 27 të ligjit nr.8577/2000, të ndryshuar me ligjin nr.99/2016)


Sa i përket ecures së jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese për vitin 2021, gjë e cila mund të vihet re edhe nga shifrat që përmbajnë statistikën bashkëgjatë të kësaj analize, mund të themi se linjat kryesore janë ato të ndjekura edhe në vitet e mëparshme.

Gjatë vitit 2021, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë janë paraqitur dhe regjistruar në total 160 kërkesa.

❖ Kërkesat e grupuara sipas objektit:

- 82 kërkesa janë paraqitur për *proces të parregullt (kundërshtim të vendimeve të gjykatave të zakonshme)*;
- 13 kërkesa janë paraqitur për *konstatim të cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor*;
- 5 kërkesa janë paraqitur për konstatim cenimi/shfuqizim vendimesh;
- 2 kërkesa janë paraqitur për deklarim mbarim mandati të gjyqtarit Kushtetues;
- 1 kërkesë është paraqitur për konflikt kompetencash;
- 35 kërkesa janë paraqitur për papajtueshmëri të *ligjeve (apo dispozitave të veçanta të tyre)* me Kushtetutën;
- 4 kërkesa janë paraqitur për *vendime të Këshillit të Ministrave*;
- 1 kërkesë është paraqitur për kundërshtim *vendimi të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë*;
- 14 kërkesa janë paraqitur për *kundërshtim/ rishikim të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese*;
- 2 kërkesa janë paraqitur për kundërshtim vendime ILD-së;
- 1 kërkesë është paraqitur për kundërshtim të *vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor*.


Kërkesat e grupuara sipas objektit në përqindje



❖ Kërkesat e grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:

- 1 kërkesë është paraqitur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;
- 2 kërkesa janë paraqitur nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese;
- 1 kërkesë është paraqitur nga jo më pak se 1/5-a, e deputetëve;
- 1 kërkesë është paraqitur nga Avokati i Popullit;
- 16 kërkesa janë paraqitur nga gjykatat e sistemit të zakonshëm (për kontroll incidental);
- 3 kërkesa janë paraqitur nga partitë politike;
- 4 kërkesa janë paraqitur nga organizata;
- 132 kërkesa janë paraqitur nga individët.

Kerkesat e grupuara sipas subjekteve



VENDIMET E DHËNA NGA GJYKATA KUSHTETUESE GJATË VITIT 2021


Gjykata Kushtetuese gjatë vitit 2021 ka dhënë në total 201 vendime, nga të cilat 42 vendime janë përfundimtare dhe 159 janë vendime moskalimi;

Më poshtë po paraqesim në mënyrë grafike të ndarë në grupe vendimet përfundimtare:

❖ Vendimet përfundimtare sipas vitit të regjistrimit të kërkesës:

- 5 vendime për kërkesat e regjistruara në vitin 2017;
- 13 vendime për kërkesat e regjistruara në vitin 2018;
- 8 vendime për kërkesat e regjistruara në vitin 2019;
- 3 vendime për kërkesat e regjistruara në vitin 2020;
- 13 vendime për kërkesat e regjistruar në vitin 2021;

Vendimet përfundimtare sipas vitit të regjistrimit të kërkesës në %




Vendimet përfundimtare të grupuar si subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese

❖ Vendimet përfundimtare të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:

- 1 kërkesë është paraqitur nga Presidenti Republikës së Shqipërisë;
- 1 kërkesë është paraqitur nga Kryeministri Republikës së Shqipërisë;
- 2 kërkesa janë paraqitur nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese;
- 1 kërkesë është paraqitur nga Avokati i Popullit;
- 1 kërkesë është paraqitur nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit
- 3 kërkesa janë paraqitur nga gjykatat e sistemit të zakonshëm (për kontroll incidental);
- 3 kërkesa janë paraqitur nga partitë politike;
- 5 kërkesa janë paraqitur nga organizata;
- 25 kërkesa janë paraqitur nga individët.


Vendimet përfundimtare të grupuar si subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në %



❖ Vendimet përfundimtare të grupuara sipas objektit të kërkesës


- 2 vendime kanë objekt Vendimet e Këshillit të ministrave
- 12 vendime janë me objekt shfuqizimin/ papajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën
- 20 vendime janë me objekt për proces të rregullt ligjor
- 1 vendim është për konflikt kompetencash
- 5 vendime janë për konstatim cenimi
- 2 kërkesa kanë objekt deklarim mbarim mandati anëtari kushtetuese

VENDIMET PËRFUNDIMTARE E GRUPURA SIPAS OBJEKTIT NË PËRQINDJE




- ❖ Vendimet përfundimtare të grupuara sipas dispozitivit të vendimit:
 - Për 7 vendime Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës;
 - Për 5 vendime Gjykata ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës;
 - Për 16 vendime Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës;
 - Për 2 vendime Gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit;
 - Për 2 vendime Gjykata ka vendosur deklarim mbarim mandati;

VENDIMET PËRFUNDIMTARE TË GRUPUARA SIPAS DISPOZITIVIT NË PËRQINDJE




- ❖ Vendimet përfundimtare të grupuara sipas mënyrës së votimit:
 - Njëzëri 22 vendime.
 - Me shumicë votash 20 vendime.

Vendimet përfundimtare të grupuara sipas mënyrës së votimit në %




Gjatë vitit 2021 nga Mbledhja e Gjyqtarëve dhe Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese janë dhënë 159 vendime.

- ❖ Vendimet e moskalimit sipas vitit të regjistrimit të kërkesës;
 - 2 vendime për kërkesat e regjistruara në vitin 2017;
 - 4 vendime për kërkesat e regjistruara në vitin 2018;
 - 6 vendime për kërkesat e regjistruara në vitin 2019;
 - 35 vendime për kërkesat e regjistruara në vitin 2020;
 - 112 vendime për kërkesat e regjistruara në vitin 2021;



❖ Vendimet e moskalimit të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:


- 20 kërkesa janë paraqitur nga gjykatat e sistemit të zakonshëm (për kontroll incidental);
- 2 kërkesa janë paraqitur nga partitë politike;
- 10 kërkesa janë paraqitur nga organizata;
- 127 kërkesa janë paraqitur nga individët.



❖ Vendime moskalimi të grupuara sipas objektit të kërkesës

- 1 kërkesa shfuqizim dekret Presidenti
- 2 kërkesa për shfuqizim akti normativ.
- 52 kërkesa për shfuqizimin/ papajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën
- 71 vendime janë me objekt për proces të rregullt ligjor
- 10 saktësim/interpretim/ rishikim vendime të Gjykatës Kushtetuese
- 20 vendime janë për konstatim cenimi
- 1 kërkesë për shfuqizim vendimi të ILD-së
- 2 kërkesa për shfuqizim vendimesh të KLGJ-së

Vendime moskalimi të grupuara sipas objektit të kërkesës në %



AKTIVITETE TË GJYKATËS KUSHTETUESE GJATË VITIT 2021

(takime, vizita zyrtare, konferenca)

Aktivitetet e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë për vitin 2021 paraqiten si në vijim:

Gjatë vitit 2021, për shkak të situatës specifike të krijuar nga pandemia COVID-19, numri i aktiviteteve të organizuara ka qenë më i reduktuar dhe kryesisht pjesëmarrja në seminare dhe konferenca ndërkombëtare është bërë nëpërmjet përdorimit të platformave online.

- ***Ndjekja dhe promovimi i zhvillimit të marrëdhënieve bilaterale ndërmjet Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe gjykatave të tjera kushtetuese/institucioneve me juridiksion ekuivalent, si dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.***

Për këtë vit janë realizuar dy vizita studimore, fillimisht e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në datat **27 – 28 maj 2021** dhe më pas vizita e kthimit e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës pranë Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, në datat **29 shtator – 1 tetor 2021**. Në kuadër të kësaj vizite, në ambientet e Gjykatës Kushtetuese, në datën **29 shtator 2021**, është bërë nënshkrimi i Marrëveshjes së re për Bashkëpunimin Reciprok dhe Ndihmën e Ndërsjellë në Fusha me Interes të Përbashkët midis Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

- **Veprimtari ndërkombëtare të zhvilluara jashtë vendit në formatin online**

- **Takimi i tretë i Rrjetit të Gjykatave Supreme - forum i GJEDNJ-së**

Në datën 12 shkurt 2021, znj. Elsa Toska, gjyqtare dhe përfaqësuese e Gjykatës Kushtetuese pranë Rrjetit të Gjykatave Supreme (SCN) – forum i GJEDNJ-së, mori pjesë në takimin e tretë online me temë: “Gjuha e urrejtjes dhe grupet vulnerabël”.

- **Kongresi i XVIII-të i Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane**

Në datat 24 – 25 shkurt 2021, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, e përfaqësuar nga znj. Vitore Tusha, Kryetare, dhe znj. Fiona Papajorgji, anëtare, mori pjesë në punimet online të Kongresit të XVIII-të të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane me temë “Katalogët e të drejtave të njeriut në nivel kombëtar – zbatimi i katalogëve të të drejtave të njeriut në nivel ndërkombëtar dhe suprakombëtar”.

- **Forumi Ligjor Ndërkombëtar i St. Petërshburgut**

Me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Federatës së Ruisë dhe organizatorëve të Forumit Ligjor Ndërkombëtar të St. Petërshburgut, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë mori pjesë në edicionin e veçantë online të Forumit të 9 ¾ Ligjor Ndërkombëtar të St. Petërshburgut: “*Vaccination by law* - aspektet ligjore të jetës publike në kushtet e shpërthimit të pandemisë COVID-19 dhe zhvillimin e zgjidhjeve ligjore në luftën kundër virusit”, i cili i zhvilloi

punimet në datat 18 - 22 maj 2021. Përfaqësuesi i Gjykatës Kushtetuese në këtë veprimtari ishte z. Përparim Kalo, anëtar i gjykatës.

- **Konferenca e 9-të e Kryetarëve të Gjykatave Kushtetuese anëtare të ACCF-së**

Më 25 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, znj. Vitore Tusha, ka marrë pjesë në Konferencën e 9-të online të Kryetarëve të Gjykatave Kushtetuese anëtare të Shoqatës së Gjykatave Kushtetuese Frankofone - ACCF. Tema e konferencës ishte “Kolegjialiteti” dhe kishte të bënte me mënyrat se si kolegjialiteti gjen zbatim në organizimin e brendshëm institucional të gjykatave kushtetuese.

- **Takimi vjetor i Rrjetit të Gjykatave Supreme - forum i GJEDNJ-së**

Në datën 11.06.2021, znj. Elsa Toska, gjyqtare dhe përfaqësuese e Gjykatës Kushtetuese në Rrjetin e Gjykatave Supreme (SCN) - pranë GJEDNJ-së, mori pjesë në takimin vjetor online me temë: “Menaxhimi i çështjeve dhe konsistenca e vendimmarrjes - perspektiva e gjykatave kombëtare dhe e GJEDNJ-së”.

- **Forumi i tetë Rajonal Vjetor i Sundimit të Ligjit për Evropën Juglindore**

Me ftesë të Qendrës AIRE (Advice on Individual Rights in Europe) dhe Civil Rights Defenders, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë mori pjesë në Forumin e Tetë Rajonal të Shtetit të së Drejtës për Evropën Juglindore me temë “Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit”, i cili i zhvilloi punimet në formatin online në datat 3 – 4 shtator 2021. Në këtë veprimtari Gjykata Kushtetuese u përfaqësua nga z. Përparim Kalo, gjyqtar.

- **Shkolla e 9-të verore e organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Turqisë**

Me ftesë të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Turqisë, Prof. Dr. Zühtü ARSLAN, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë mori pjesë në programin e shkollës së 9-të verore të organizuar nga Qendra për Trajnimin dhe Zhvillimin e Burimeve Njerëzore e Shoqatës së Gjykatave Kushtetuese Aziatike dhe Institucioneve Ekuivalente. Tema e përzgjedhur për këtë vit ishte “Probleme aktuale të ekzekutimit të vendimeve: Drejtësia Kushtetuese” dhe programi u zhvillua online në datat 7 – 8 shtator 2021. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë u përfaqësua në këtë aktivitet nga znj. Ela Elezi, këshilltare ligjore, e cila mbajti edhe një referim.

- **Takimi i 13-të i Nën-komitetit të Stabilizimit dhe Asociimit BE-Shqipëri për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë**

Në datat 9 – 10 dhjetor 2021, Nën-komiteti i Stabilizimit dhe Asociimit BE-Shqipëri për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë zhvilloi takimin e tij të trembëdhjetë në të cilin morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë nga institucione të ndryshme në fushën e drejtësisë, si dhe ekspertë në fushën e të drejtave themelore. Përfaqësuese e institucionit të Gjykatës Kushtetuese në këtë aktivitet ishte zonja Fiona Papajorgji, anëtare e Gjykatës Kushtetuese.

➤ **Seminare dhe tryeza diskutimesh brenda vendit**

- **Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë - Prezenca në Shqipëri.**

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë znj. Vitore Tusha dhe Ambasadori i Zyrës së Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, SH.T.Z. Vincenzo Del Monaco, nënshkruan në datën 14.04.2021, Memorandumin e Mirëkuptimit për “Bashkërendimin dhe bashkëpunimin në zbatimin e projekteve dhe veprimtarive që synojnë të mbështesin Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

- **Ceremonia e finalizimit të Dokumentit të parë Strategjik të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë**

Më 22 prill 2021, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë zhvilloi ceremoninë zyrtare të finalizimit të Dokumentit të Parë Strategjik të saj. Nëpërmjet këtij plani, Gjykata angazhohet të përmirësojë teknologjinë e menaxhimit të çështjeve, të rrisë kapacitetet njerëzore për shqyrtim me cilësor e efikas të çështjeve në respektim të afateve ligjore, të ndërmarrë hapa për të rritur aksesin e publikut në Gjykatë, si dhe për të forcuar besimin e qytetarëve tek Gjykata.

- **Aktiviteti me temë "Tryezë teknike për masat e planit të veprimit për vitin 2021 në zbatim të Strategjisë së Gjykatës Kushtetuese (2021-2023)".**

Në datat 8-9 korrik 2021, u zhvillua aktiviteti ndërkombëtar me temë: “Tryezë teknike për masat e planit të veprimit për vitin 2021 në zbatim të Strategjisë së Gjykatës Kushtetuese (2021-2023)”. Të pranishëm në këtë aktivitet, që u mbajt në qytetin e Sarandës, ishin gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe stafi administrativ i saj, përfaqësues të Zyrës së Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, të fondacionit gjerman “Konrad Adenauer”, si dhe një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

- **Aktiviteti i përbashkët midis Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë**

Në datën 19 nëntor 2021 u zhvillua një aktivitet i përbashkët midis Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë me temë “Juridiksioni kushtetues dhe juridiksioni gjyqësor – vija ndarëse ndërmjet tyre. Si krijohen, zhvillohen dhe ndryshohen standardet kushtetuese në aspektin procedural”. Në këtë aktivitet, i mundësuar me mbështetjen e Fondacionit Hanns Seidel, morën pjesë gjithë trupa e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, si dhe përfaqësues e këshilltarë ligjorë nga të dyja gjykatat.

- **Aktiviteti i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë në bashkëpunim me zyrën e Prezencës së OSBE-së në Tiranë**

Në datat 9 – 10 dhjetor 2021 u zhvillua tryeza e rumbullakët me temë “Zbërthimi i zërave të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese në funksion të organizimit të 30 vjetorit të saj”. Ky aktivitet u organizua nga Gjykata Kushtetuese me gjyqtarët, këshilltarët ligjorë dhe stafin e saj administrativ, si dhe me pjesëmarrjen e këshilltares ligjore lokale e zyrës së prezencës së OSBE-së në Tiranë, znj. Ama Kraja, e cila ofroi ekspertizën e saj lidhur me modalitetet e organizimit të këtij përvjetori, veçanërisht në kushtet e kufizimeve të shkaktuara nga pandemia COVID-19.

- **Aktiviteti i përbashkët me Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Avokaturën e Shtetit**

Gjykata Kushtetuese, me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe Konrad Adenauer Stiftung, zhvilloi, në datën 16 dhjetor 2021, tryezën e rumbullakët me temë “Ankimi kushtetues individual”, me pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, përfaqësuesve të Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe të Avokaturës së Shtetit.

- **Takim i Kryetares së Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë me Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës**

Në datën 19.01.2021, Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, znj. Vitore Tusha, është pritur në një takim nga Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Sh.S.znj. Yuri Kim. Në fokus të këtij takimi ka qenë funksionimi i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë dhe ecuria e veprimtarisë së saj.

- **Vizitë e Ambasadores së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe e Ambasadorit të Bashkimit Europian në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë**

Në datën 21.01.2021, trupa e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, e kryesuar nga znj. Vitore Tusha, Kryetare, zhvilloi një takim zyrtar në ambientet e kësaj Gjykate me Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Shkëlqesinë e Saj znj. Yuri Kim, si dhe Ambasadorin e Bashkimit Europian, Shkëlqesinë e Tij z. Luigi Soreca.

- **Takim kortezie me Ambasadorin e Greqisë në Tiranë**

Në datën 05.03.2021, znj. Vitore Tusha, Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, priti në një takim kortezie në ambientet e kësaj Gjykate, Ambasadorin e Greqisë në Tiranë, SH. S. znj. Sophia Philippidou.

- **Takim online i delegacionit të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale me gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë**

Në kuadër të monitorimit të respektimit të angazhimeve dhe detyrimeve të ndërmarra nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës që kanë nënshkruar dhe ratifikuar Kartën Europiane të Autonomisë Vendore, një delegacion i Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale zhvilloi në datën 18 mars 2021, një takim online me një delegacion të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë të përbërë nga Kryetarja znj. Vitore Tusha dhe anëtarët znj. Marsida Xhaferllari dhe znj. Fiona Papajorgji.

- **Takim me përfaqësues të Misionit të Kufizuar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve në Shqipëri**

Në datën 16.04.2021, znj. Vitore Tusha, Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, priti në një takim në ambientet e kësaj gjykate, një delegacion të Misionit të Kufizuar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve në Shqipëri të kryesuar nga znj. Urszula Gacek, Kreu i këtij Misioni.

- **Takim i Kryetares së Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë me Ambasadorin e Austrisë në Shqipëri**

Në datën 19.05.2021, znj. Vitore Tusha, Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, e shoqëruar edhe nga z. Përparim Kalo, gjyqtar, priti në një takim kortezie në ambientet e kësaj Gjykate, Ambasadorin austriak z. Christian Steiner, dhe Këshilltarin për Evropën Juglindore në Ministrinë Federale të Drejtësisë në Republikën Austriake, z. Georg Stawa.

- **Takim kortezie me Ombudsmanin e Republikës së Kosovës.**

Në datën 22.06.2021, Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, znj. Vitore Tusha, priti në ambientet e kësaj gjykate një delegacion të institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës, i cili, në kuadër të bashkëpunimit institucional me Avokatin e Popullit të Shqipërisë, zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë.

- **Vizitë e Ambasadores së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Shkëlqesisë së Saj Zonjës Yuri Kim në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë**

Në datën 16.09.2021, trupa e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, e kryesuar nga zonja Vitore Tusha, Kryetare, zhvilloi një takim zyrtar në ambientet e kësaj Gjykate me Ambasadoren e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Shkëlqesinë e Saj zonjën Yuri Kim.

- **Takim i Kryetares së Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, Znj. Vitore Tusha, me Ambasadoren e Francës në Shqipëri, Shkëlqesinë e Saj Znj. Elisabeth Barsacq.**

Në datën 17.09.2021, Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, znj. Vitore Tusha, zhvilloi një takim zyrtar në ambientet e kësaj Gjykate me Ambasadoren e Francës në Shqipëri, SH.S. Znj. Elisabeth Barsacq.

VEPRIMTARIA EKONOMIKE DHE FINANCIARE E GJYKATËS KUSHTETUESE GJATË VITIT 2021

VEPRIMTARIA EKONOMIKE DHE FINANCIARE E GJYKATËS KUSHTETUESE GJATË VITIT 2021


Drejtoria Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore në arritjet e objektivave të punës së saj për vitin 2021, ka patur plotësimin e vendeve të lira të punës nëpërmjet procedurave të rekrutimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore për të siguruar kushte sa më të mira pune me shërbime administrative, mallra etj. për rritjen e efektivitetit të rezultateve në punë të punonjësve të gjykatës.

I- Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe plotësimi i vendeve të lira të punës

- Gjatë vitit 2021, u realizuan procedurat për plotësimin e vendeve të lira të punës me 15 punonjës, nga të cilët 4 janë këshilltarë ligjorë, 3 janë specialistë të nivelit të lartë me status nëpunësi civil, si dhe 8 janë punonjës mbështetës.
- Sipas Ligjit Nr. 137/2020, datë 16.11.2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, u detajua numri i punonjësve në organikë, sipas strukturës organizative për 62 punonjës dhe ju dërgua për zbatim Ministrisë së Financave dhe Degës së Thesarit, Tiranë.
- U plotësuan 90% vendet e punës në organikë duke punësuar 56 punonjës, gjithsej.

Nga numri i përgjithshëm prej 56 punonjësish në organikë, 30 janë të gjinisë femërore dhe 26 meshkuj. Grafiku sipas strukturës gjinore për punonjësit në organikë:

PESHA SPECIFIKE E PUNONJËSVE SIPAS GJINISË




Numri i punonjësve në organikë, sipas strukturës organizative është:



- 7 gjyqtarë, anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, nga të cilët një është Kryetari;
- 10 këshilltarë ligjorë;
- 2 nëpunës të kabinetit të Kryetarit;
- 21 nëpunës civil;
- 16 punonjës mbështetës.

Paraqitja grafike e numrit të punonjësve sipas strukturës organizative:

PESHA SPECIFIKE SIPAS STRUKTURËS ORGANIZATIVE



Struktura e kategorisë së punonjësve “nëpunës” prej 40 nëpunës në trajtë grafike është:



II - Mbështetja me shërbime administrative e logjistikë.

Sektori i Shërbimeve të DEBNJ, sipas buxhetit të miratuar ka plotësuar nevojat me shërbime administrative, furnizim me mallra, pajisje e inventar tjetër të zyrave për të siguruar e ofruar kushte sa më të mira pune për punonjësit e Gjykatës duke mbajtur parasysh objektivat e mëposhtme:

- U mbështet dhe u ofrua ndihmë logjistike e profesionale për përdorimin e shfrytëzimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve.
- Për plotësimin e nevojave të furnizimit me mallra e shërbime sipas regjistrit të prokurimeve u realizuan 4 tendera publikë dhe 52 procedura prokurimi me vlerë të vogël.
- U realizuan investimet e parashikuara për rinovimin e parkut të automjeteve, pajisjet e zyrave etj.
- Pasurimi i fondit të bibliotekës me 28 tituj të rinj të jurisprudencës, me Fletoren Zyrtare, si dhe me botime të tjera periodike të huaja dhe të vendit.
- Mirëmbajtja periodike e automjeteve për të siguruar gadishmërinë teknike sa më të lartë të tyre.
- Sigurimi dhe furnizimi i rregullt i automjeteve me karburante.
- Janë riparuar e mirëmbajtur ambientet e brendshme dhe godina e Gjykatës duke riparuar defektet teknike të rrjetit të furnizimit me energji, ujë, pajisje e inventarin tjetër që disponon institucioni.
- Seleksionimi i aseteve, materialeve e inventarit stok e jashtë përdorimit të zyrave duke realizuar procedurat ligjore të vlerësim-verifikimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit ose të kalimit kapital të tyre.

III- Të tjera

- Realizimi dhe mbështetja e të gjithë veprimtarive të organizuara nga Gjykata, brenda dhe jashtë vendit në kuadër të objektivave të programuara të vitit 2021.
- Mosvijimi i projektit të informatizimit të plotë të veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese për mungesë të fondeve nga buxheti i shtetit.
- Mungesë e ambienteve të nevojshme të punës për TI, sallë mbledhje, e mjedise normale pune për punonjësit.

IV - Buxheti dhe financat.

Në zbatim të nenit 13, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të R.SH.”, bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të ligjit nr. 137/2020, date 16.11.2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, buxheti i Gjykatës Kushtetuese për vitin 2021, nga 150,200,000 lekë është plotësuar 131,501,974 lekë. Sipas strukturës së kategorive ekonomike buxheti faktik është:

Në lekë

Pagat dhe sigurimet shoqërore (600-601)	Shpenzime operative (602)	Transferta korrente të huaja (605)	Transferta të brendshme (606)	Investime kapitale (231)	Gjithsej
105,769,720	21,319,452	442,200	132,522	3,838,080	131,501,974

Buxheti i vitit 2021, është realizuar 131,501,974 lekë ose 88 % e buxhetit të alokuar i cili paraqitet si më poshtë:

në lekë

<i>Zërat e buxhetit</i>	Llogaria e buxhetit	Buxheti i vitit 2021			
		i miratuar	i rishikuar	i realizuar	Në %
<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	<i>6 (5/4)</i>
Pagat	600	113,000,000	108,000,000	95,388,166	88
Sigurime shoqërore	601	12,000,000	12,000,000	10,381,554	87
Shpenzime operative	602	25,500,000	25,500,000	21,319,452	84
Shpenzime për transferta korrente të huaja	605	500,000	500,000	442,200	88
Shpenzime transferta të brendshme	606	0	200,000	132,522	66
Investime kapitale	231	4,000,000	4,000,000	3,838,080	96
Totali i buxhetit		155,000,000	150,200,000	131,501,974	88

Realizimi i buxhetit të vitit 2021, për investimet:

në lekë

Investimi	Plan	Fakt	Në %
Paisje informatike	1,120,000	1,114,680	100
Rrjeti informatik	1,080,000	1,077,600	100
Tituj librash për bibliotekën	605,000	503,000	83
Paisje zyre	1,195,000	1,142,800	96
Totali	4,000,000	3,838,080	96